



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:196878

Datë: 11.10.2024

Numri i dokumentit: 06289072

C.nr.568/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.Knga fshati Senoc, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Dardan Morina nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike kompensimi i ushqimit në punë, vlera e objektit të kontestit 318.00 euro, jashtë seancës, më datën 11.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit R.K.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit R.Knga fshati Senoc, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 01.01.2022 e deri më datën 21.11.2022 për 159 ditë pune të ja paguajë shumën prej 318.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 18.06.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit R.K, t'i paguajë shumën prej 99.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi R.K, më datën 18.06.2024, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit në punë në shumën prej 318.00 euro.

I njëjti sipas padisë ka theksuar se është në marrëdhënie pune në bazë të kontratës së punës në vendin e punës në SHMFU “Vëllezërit Frashëri”, në fshatin Drenoc, Komuna e Rahovecit. Duke shtuar se për periudhën kohore nga data 01.01.2022 e deri më datën 21.11.2022, i takon kompensimi për ushqim në punë, për një ditë pune shuma prej 2 euro, në bazë të nenit 35 par.7

të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 18.09.2024, ka theksuar se e kontestojnë padinë në tërësi për shkak se drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse është e pavlefshme. Paditësi ka ushtruar padi në gjykatë më 18.06.2023, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, për periudhën kohore nga 01.01.2022 – 21.11.2022, me mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017. Kërkesëpadinë e paditëses e konteston në tërësi edhe mbi bazën që më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar, si dhe paditësi pranë kësaj gjykate ka parashtruar edhe një padi për kompensimin të ushqimit me numër C.nr.1565/2023, për periudhën kohore nga data 22.01.2021 – 21.11.2022. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: vërtetimit me Nr.355/05, i datës 22.05.2024, i lëshuar nga SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në fshatin Drenoc, Komuna e Rahovecit dhe kontratën e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 42/05, e datës 02.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit R.K.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësi për periudhën e kërkuar kohore ka prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësit pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë, si dhe a është parashkruar e drejta për të kërkuar kompensimin e ushqimit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me 355/05, i datës 22.05.2024, gjykata vërtetoi faktin se paditësi R.K, në periudhën kohore prej datës 01.01.2022 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 159 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës pa numër të protokollit 42/05, e datës 02.09.2019, të lidhur ndërmjet paditësit R.K dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në fshatin Drenoc, Komuna e Rahovecit.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit për faktin se paditësit në periudhën kohore nga data 01.01.2022 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e tij të punës ka prezantuar në 159 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësi ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”*. Në rast se shumëzohen 159 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro të paditësit Xhavit Gashi, për secilën ditë të prezencës në punë, do të kemi shumën e përgjithshme prej 318.00 euro.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditësit është dorëzuar më datën 18.06.2024, ndërsa kërkesëpadija e paditësit përfshin periudhën kohore prej datës 01.01.2022 deri me datën 21.11.2022. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të të paditurës se paditësi ka parashtruar edhe një padi tjetër për kompensim të ushqimit në punë me numër C.nr.1565/203 për periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri më datën 22.11.2022, gjykata i vlerëson si të pabazuar. Pasi që sipas parashtrësës për precizim të kërkesëpadisë të datës 13.06.202, paditësi me padin të evidentuar me numër C.nr.1565/203 - SMIL 2023:304352, ka kërkuar kompensim për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri më datën 31.12.2021.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Pjesa tjetër e shpenzimeve procedurale mbi shumën e aprovuar gjykata e refuzoi për shkak se paditësi për përpilimin e padisë ka kërkuar kompensim në shumë prej 104.00 euro, mirëpo pasi që në këtë çështje kontestimor kemi të bëjmë me kontestin e vlerës së vogël, të njëjti i takon kompensimin lidhur me përpilimin e padisë në shumën prej 78.00 euro. Andaj, gjykata e ka refuzuar pjesën e shpenzimeve procedurale mbi shumën e gjykuara dhe atë në shumën prej 26.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.568/2024, më datën 11.10.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.